



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.84/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Shkëlqim Qerimi nga Zvicra, paraqitur kundër njoftimit-vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 28.09.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si i pabazuar** apeli ZL Anr.84/2017 e datës 26.09.2017, e parashtruar nga Shkëlqim Qerimi nga Zvicra, me të cilën kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës

## A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Shkëlqim Qerimi nga Zvicra, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 13.09.2017 në të cilën pretendohet se njëjti i është refuzuar nga KQZ-ja kërkesa për të votuar edhe pse i njëjti thekson se i posedon të gjitha dokumentet të cilat ja mundësojnë që të votoj. Parashtruesi i apelit në cilësi të provës ka bashkangjitur njoftimin e KQZ-së, formularin e aplikimit për regjistrim të votuesve jashta Kosovës, pasaportën Zvicerrane dhe një shkresë në gjuhë gjermane.

Në përgjigjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 27.09.2017, theksohet se periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka filluar me 16.07.2017 dhe ka mbaruar me 23.08.2017, ndërsa lista votuese për zgjedhjet lokale 2017 është certifikuar me datën 22.09.2017 me vendimin 1762/2017, ndërsa ankuesi Shkëlqim Qerimi ka aplikuar për votim jashtë Kosovës dhe se të njëjtit ju është refuzuar kërkesa pasi që dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar gjatë aplikimit, dhe nga dokumentet e ofruara nuk ka dëshmuar se ka të drejt të përfshihet në listën votuese jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015-Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet se: *“çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”*, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”*.

Nga shkresat e lëndës Paneli gjeti se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës i njëjti ka aplikuar me pasaportë Zvicerane, dhe se me dokumentet e ofruara për regjistrim nuk ka dëshmuar se ka të drejtë të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës pasi që dosja e tij nuk ka qene e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç përcaktohet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL A nr. 84/2017 më datën 28.09.2017.



#### ***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*